



DEKLARATA E PROGRAMIT VJETOR

HISTORIKU

Tetra Tech, në pajtim me autoritetin e dhënë në Dekretin për Ndhimë të Jashtme të SHBA-së të vitit 1961, të ndryshuar, është duke kërkuar koncept dokumentet nga kompanitë private dhe shoqatat e kualifikuara për të ndihmuar në zbatimin e aktivitetit Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale. Financimi për këtë aktivitet është dhënë nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) me numër kontrate AID-167-C-15-00001

SYNIMET E PROGRAMIT

Aktiviteti Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale është program i financuar nga USAID-i për të zhvilluar një sektor më konkurrues bujqësor në Kosovë përmes ndihmës teknike dhe granteve për fermerët, ndërmarrjet dhe organizatat tjera në zinxhirët e vlerave të synuara. Aktiviteti Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale funksionon sipas tri fushave të gjera të programit të referuara si Rezultate ose Komponente. Këto janë:

- (1) Përmirësimi i prodhimit bujqësor dhe përpunimit të ushqimit
- (2) Zgjerimi i lidhjeve me tregjet e brendshme, rajonale dhe ndërkombëtare
- (3) Forcimi i partnerëve strategjikë

Aktiviteti Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale (në tekstin e mëtuftjeshëm i referuar si "Aktiviteti") do të arrijë ndikim maksimal të qëndrueshëm në sektorin bujqësor që matet kryesisht nga shitjet e zgjeruara të prodhimeve ushqimore të Kosovës, rritja e të ardhurave të fermerëve, si dhe nga mundësitë e reja për krijimin e vendeve të punës. Si rezultat i vlerësimeve dhe studimeve të mëparshme të zinxhirit të vlerës të kryera nga USAID / Kosovë, dhe punës nga projektet e mëparshme bujqësore, Aktiviteti do të mbështesë zhvillimin brenda nën-sektorëve specifik bujqësor duke përfshirë Pemët e imëta (dredhëzën, boronicën, mjedrën, manaferrën); **Pemët drunore** (mollën, dardhën, vishnjën dhe rrushin e tryezës); Kulturat perimore (perimet fushore dhe të serave me theks të veçantë specat, sallatën e gjelbërt, domatet, kornishonët dhe shpargun); Bimët mjekësore dhe aromatike, si dhe prodhimet e qumështit. Përveç kësaj, Aktiviteti mund të zhvillojë komponentë që dalin nga zinxhirët e vlerës të tilla si paketimi, furnizimi me inpute dhe shërbimet këshilluese të sektorit privat në kuadër të këtyre nën-sektorëve në mënyrë që t'i përgjigjet më mirë tregjeve të reja dhe mundësive komerciale. Aktiviteti do të kërkojë që të rrisë përfshirjen e grave, rinisë dhe pakicave në sektorin e bujqësisë duke lehtësuar kontributin e tyre në rritjen e produktivitetit bujqësor dhe zhvillimit ekonomik.

Me qëllim që të arrijë ndikim të qëndrueshëm, Aktiviteti Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale do të punojë me një grup të Partnerëve Strategjik (PS). **"Partnerët Strategjikë" janë akterë të sektorit publik dhe privat që kanë masën kritike, njohuritë teknike dhe kapacitetin prodhues për të përsheptuar zhvillimin bujqësor të udhëhequr nga tregu. AKëtu mund të përfshihen grumbulluesit e mëdhenjë (qendrat e grumbullimi, paketuesit dhe përpunuesit), tregtarët e inputeve, fermerët komercial, shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve, institucionet e sektorit publik ose privat që ofrojnë shërbime mbështetëse për sektorin e bujqësisë, si dhe aktorë të tjerë që punojnë të gjithë së bashku ose në mbështetje të zinxhirëve të vlerave të synuara.** Lidhjet efektive mes këtyre partnerëve strategjikë do të formojnë bazën për aktivitet dhe zhvillim më të gjerë të zinxhirit të vlerës. Partnerët strategjikë do të luajnë një rol vendimtar në aspekte të ndryshme të zhvillimit të zinxhirit të vlerës, duke përfshirë por jo edhe kufizuar kontraktimin e prodhuesve, grumbullimin e produktit, paketimin, përpunimin, ftohjen, ruajtjen, shitjet dhe marketingun, ofrimin e shërbimeve këshillimore teknike ose financiare, si dhe inputet e shërbimet tjera. Aktiviteti gjithashtu do të ndihmojë të diplomuarit e rinj, gratë dhe pakicat e angazhuara në aktivitetet e prodhimit bujqësor dhe krijimin e agrobizneseve dhe do të mbështesë shoqatat rurale me orientim komercial, si dhe organizatat e prodhuesve për të zhvilluar kapacitetet e tyre në mbështetje të zhvillimit brenda sektorit bujqësor.

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË GRANTEVE

Kjo Deklaratë e Programit Vjetor (DPV) ka për qëllim të bëj thirrje për koncept dokumentet në lidhje me aktivitetet që do të financohen nga Fondi për Grante Inovative dhe Shtytëse i Aktivitetit (IIF). Fondi për Grante shtytëse do të fokusohet në veçanti në: 1) pozicionimin e PS-ve të sektorit privat (dhe mundësisht disa të sektorit publik) që të bëhen drejtuesit kryesorë të zhvillimit bujqësor; dhe 2) tërheqjen e më shumë grave, të rinjve, dhe pakicave në sektorin bujqësor duke i ndihmuar ata të fillojnë ose zgjerojnë aktivitetet ekzistuese të agrobiznesit. Mbështetja përmes programit IIF do të ndihmojë përfituesit e granteve në arritjen e progresit për sa i përket komponentës 1 të Aktivitetit (Përmirësimi i prodhimit bujqësor dhe përpunimit të ushqimit) dhe 2 (Zgjerimi i lidhjeve me tregjet e brendshme, rajonale dhe ndërkombëtare) dhe nëduke bërë kështu, do të rezultojë në komponentën 3 (Forcimi i partnerëve strategjik).

Grantet për PS-të (**siç janë përkufizuar me shkronja të zeza më lart**) do të bazohen në shënimet e konceptit të kualifikuar të dorëzuar në përgjigje për këtë Deklaratë të Programit Vjetor (DPV), dhe plotësisht të përpiluara në bashkëpunim me stafin e Aktivitetit para dhënies së grantit. Grantet për PS-të mund të jenë me kohëzgjatje afat-shkurte deri afat-mesme (të implementuara prej 6 deri 36 muaj) dhe do të radhiten sipas idesë themelore dhe vlerës monetare në varësi të nevojave të PS-së që aplikon. Grantet për PS-të do të imponojnë një kriter strikt të ndarjes së saktë të kostos në të paktën 1:1, në mënyrë që të barazpeshohet investimi privat.

Grantet për gratë, të rinjtë, dhe agrobizneset fillestare (ose të zgjeruara) në pronësi të pakicave do të sigurojnë deri në 75% të kostos së zhvillimit të agrobiznesit të propozuar. Për këtë lloj të grantit, kontributet në natyrë të përfituesit të grantit (puna, materialet dhe pajisjet) do të jenë të pranueshme si bashkë-financim. Aktiviteti mund të ofrojë ndihmë teknike dhe mbështetje në natyrë në formë të inpueteve¹, materialeve fidanore², pajisjeve³ dhe mbështetje për aktivitetet e zhvillimit të tregut. Këto grante do të jenë më të vogla në shtrirje dhe vlerë monetare sesa grantet e PS-ve dhe me kohëzgjatje më të shkurtër (deri në 1 vit) për të nisur iniciativat e biznesit dhe për t'i lidhur ato me PS-të që mund të lehtësojnë integrimin e tyre të plotë në zinxhirët e vlerave të synuara.

Shuma totale e fondeve në dispozicion për çdo lloj granti, vlera e pritur mesatare e çdo granti, numri i granteve që do të jepet dhe lloji i aktiviteve që mund të mbështeten në çdo lloj granti janë të detajuara në Tabelën 1 më poshtë:

TABELA 1: Alokimi i granteve IIF	
Grantet për Partnerët Strategjikë për të mbështetur planet e zhvillimit të biznesit (PZHB-të)	Grantet për Gratë, Rininë dhe Pakicat për të mbështetur fillimin apo zgjerimin e biznesit
<i>Fondet në dispozicion: \$2.0M (gjatë jetës së aktivitetit)</i> <i>Kohëzgjatja: Deri në 3 vjet</i> <i>Vlera/Granti mes.: \$50,000 # Granteve të pritshme: 40</i>	<i>Fondet në dispozicion: \$400,000 (gjatë jetës së aktivitetit)</i> <i>Kohëzgjatja: Deri në 1 vjet</i> <i>Vlera/Granti mes.: \$10,000 # Granteve të pritshme 40</i>
Lloji i aktiviteve të mbështetura	
<ul style="list-style-type: none"> Implementimi i PZHB-ve afatgjate formale i PS-ve të zhvilluara në bashkëpunim me stafin dhe këshilltarët e Aktivitetit. Mund të ofrojë mbështetje në natyrë për të ndarë kostot e ndihmës teknike dhe menaxheriale, përmirësimin e sistemeve të menaxhimit/komunikimit, risitë në pajisjet e përpunimit në objekte, trajnime, vizita studimore, organizime të ngjarjeve B2B, pjesëmarrje në panairë të tregtisë dhe teknologjisë, aktivitete fushore dhe të marketingut, sigurimin e shërbimeve të përmirësuara këshillimore në sektorin privat dhe shtimin e certifikimit për siguri ushqimore, zhvillimin e shërbimeve të grumbullimit dhe shpërndarjes së produktit, përmirësimin e paketimit, brendimit dhe etiketimit, përvetësimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit, zhvillimin e sistemeve informative të tregut, programet e stazhit, krijimin e vendeve të punës, seminarët, punëtoritë dhe konferencat. 	<ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e aktiviteve prodhuese dhe agrobizneseve fillestare ose të zgjeruara të grave, të rinjve dhe pakicave. Mund të japë inpuete bujqësore, materiale fidanore, pajisje të prodhimit dhe përpunimit, trajnime dhe shërbime të zhvillimit teknik dhe/ose të biznesit, futjen e teknologjive të përmirësuara të prodhimit dhe/ose pas-vjeljes, zhvillimin e brendimit, etiketimit, paketimit të produktit, aktivitetet e lidhjes me tregun duke përfshirë ngjarjet e promovimit të produktit, pjesëmarrjen në vizita studimore dhe në panairët e tregtisë dhe teknologjisë.

Aktiviteti do të sigurojë fondet e grantit duke përdorur Dispozitat Standarde të USAID-it për dhënien e

¹ Pesticidet dhe plehërat janë mallra të kufizuar dhe kërkojnë miratimin paraprak të USAID-it.

² Mund të aplikohet miratimi paraprak i USAID-it për disa mallra bujqësorë

³ Është politikë e USAID-it që të financojë vetëm pajisjet e papërdorura përveç në rastet kur jepet arsytimi dhe USAID-i jep miratimin paraprak.

granteve në natyrë, të thjeshtuara, në shuma fikse, dhe granteve standarde. Grantet që variojnë nga 5,000\$ deri 100,000\$, do të jepen për partnerët strategjikë, ndërmarrjet/agrobizneset e sektorit privat, shoqatat të tilla si organizatat e prodhuesve dhe për aktorët e tjerë të zinxhirit të vlerës, aktivitetet e propozuara të të cilëve i përmbushin kriteret e deklaruara të pranueshmërisë dhe vlerësimit dhe që kontribuojnë ndjeshëm në rezultatet e pritshme të Aktivitetit Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale.

Aktiviteti është veçanërisht i interesuar në marrjen e aplikimeve, në bazë të kësaj deklarate vjetore të programit, nga aktorët e zinxhirit të vlerës që janë të gatshëm të zgjerojnë shërbimet këshillimore të sektorit privat, të ofrojnë shërbimet e zgjerimit të certifikimit për siguri ushqimore (të tilla si GlobalGAP), të përmirësojnë promovimin në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare për produktet e freskëta dhe të përpunuara të Kosovës dhe për shërbime të zgjeruara në sektorin e agrobiznesit duke shfrytëzuar aplikimin inovativ të teknologjisë së informacionit, si dhe marrjen e aplikimeve nga ndërmarrjet e zotëruara nga gratë/pakicat ose të rinjtë që futen ose kërkojnë të zgjerojnë prodhimin dhe/ose përpunimin e pemëve dhe perimeve të synuara

UDHËZIME

Aplikantët që kanë të drejtë konkurimi duhet të dorëzojnë një koncept dokument, pesë faqe ose më pak që përmban informacionin e mëposhtëm:

- Tregon qartë se për cilin lloj të grantit jeni duke aplikuar (PS ose fillestar në agrobiznes);
- Historikun e shkurtë dhe profilin organizativ të agrobiznesit. Ky seksion duhet të japë hollësi se si aplikanti i plotëson kriteret për kualifikim të detajuar në seksionin e mëposhtëm i titulluar si i tillë;
- Deklarimi i problemit që duhet të trajtohet nga granti;
- Vizioni i përgjithshëm i PS-së ose agrobiznesit duke përfshirë synimet dhe objektivat dhe një përshkrim se si granti do të kontribuojë në realizimin e atij vizioni;
- Një përshkrim të llojit dhe numrit të aktorëve të zinxhirit të vlerës të përfshirë/prekur dhe në çfarë niveli (prodhuesit, përpunuesit, furnizuesit e inputeve, etj.) dhe se si granti do të implementohet si një pjesë integrale e biznesit të aplikantit ose planit zhvillimor;
- Një përshkrim përmbledhës i aftësive të aplikantit në aspektin e "meritës së grantit", duke përfshirë personelin në dispozicion për praktikën e aktivitetit, financave dhe administratës, performancën në projekte të ngjashme dhe përvojën në rajonin gjeografik;
- Një përshkrim të përgjithshëm se kush do të përfitojë nga aktiviteti i propozuar; të ndahen përfituesit sipas gjinisë, moshës dhe grupit etnik.
- Një vlerësim të buxhetit të shumës totale të financimit të Grantit dhe kontributit të përfituesit, në para të gatshme dhe në sende, që do të jetë i nevojshëm për të zbatuar programin, dhe;
- Pika e kontaktit, duke përfshirë emrin, titullin, adresën, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike.

APLIKANTËT E PRANUESHËM

Përfituesit e Granteve IIF (për PS-të dhe bizneset fillestare) mund të përfshijnë:

Llojet e organizatave si në vijim - OJQ-të Jo-Amerikane, subjektet e regjistruara në Kosovë (entitetet qeveritare janë të përjashtuara), organizatat jo-qeveritare fitimprurëse dhe jo-fitimprurëse.

Në mënyrë që të kualifikohen si një Partner i mundshëm Strategjik, aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për partnerët strategjikë:

- Ka masën kritike dhe ndikimin për sa i përket aftësisë së tij për të mobilizuar/mbështetur njerëzit dhe institucionet
- Posedon njohuri minimale teknike dhe është i etur për të mësuar teknologjitë e përmirësuara dhe praktikën e menaxhimit
- Ka kapacitet të konsiderueshëm produktiv (qasje në kapital, tokë dhe objekte të kapacitetit të lartë)
- Zë një pozitë strategjike në zinxhirin e vlerës (tregtar i inputeve, prodhues, qendër grumbulluese, përpunues, etj.)
- Kupton dinamikën e zhvillimit të udhëhequr nga tregu
- Sjell një frymë gjithëpërfshirëse sipërmarrëse

Në mënyrë që të kualifikohet si një përfitues i mundshëm i agrobiznesit fillestar ose të zgjeruar, përfituesi i mundshëm dhe/ose agrobiznesi/aktiviteti që do të mbështetet duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë të paktën 50% në pronësi të një gruaje, pakice ose personi jo më të moshuar se 30 vjeç (ose grupit të tyre)
- Të fokusohet kryesisht në një ose më shumë zinxhirë të vlerave të synuara të Aktivitetit
- Të mos jetë i angazhuar në blerjen dhe shitjen e produkteve të menaxhimit të dëmtuesve ose produkteve tjera që nuk janë të përfshira në listën e produkteve të miratuara në PERSUAP të Aktivitetit
- Të jetë në gjendje të kontribuojë në minimum deri në 25% në ndarjes të kostos

Përveç kësaj, të gjithë PS-të dhe aplikantët për grante të agrobizneseve fillestare ose të zgjeruara duhet të tregojnë se ata:

- Posedojnë kapacitete të shëndosha menaxheriale, teknike dhe institucionale për të arritur rezultatet e projektit;
- Posedojnë dhe aplikojnë një sistem të kontrolleve të brendshme në mënyrë që të mbrojnë pasuritë dhe të mbrohen nga mashtrimi, humbjet dhe konfliktet e interesave;
- Qëndrojnë mirë me të gjitha autoritetet civile dhe fiskale;
- Posedojnë llogaridhënie financiare dhe mirëmbajnë (ose për fillestarët, kanë një plan për të mirëmbajtur) shënime të hollësishme për të gjitha shpenzimet; dhe
- Jane të gatshëm për të nënshkruar garanci dhe dëshmi të zbatueshme.
- Janë të regjistruar plotësisht në Kosovë

APLIKANTËT E PAPANUESHËM

Organizatave të mëposhtme **nuk** janë të pranueshme për financim nga fondi për Grante IIF nga Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale:

- Çdo subjekt që është një "organizatë private vullnetare" ("OPV") që nuk është regjistruar si e tillë në USAID;
- Partitë politike dhe vartësit ose filialet e tyre;
- Organizatat që shfaqen në Listën e Palëve të Përrjashtuara nga Programet e Prokurimit dhe Jo-Prokurimit Federal ose në listën 1267 të Kombeve të Bashkuara;
- Organizatat që promovojnë ose angazhohen në aktivitete të paligjshme ose aktivitete anti-demokratike;
- Organizatat fetare që nuk janë në përputhje me Sistemin e Automatizuar të Udhëzimeve (SAU) 303.3.6.4.m, i cili është në përputhje me Urdhërin Ekzekutiv 13279, Mbrojtje të Barabartë për Ligjet e Organizatave të Komuniteteve Fetare;
- Çdo subjekt i lidhur me Tetra Tech, zyrtarët, drejtorët, ose punonjësit e saj;
- Çdo Organizatë Ndërkombëtare Publike (ONP).

PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR GRANT

Formati i koncept dokumentit mund të merret në zyrat e Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale në Prishtinë ose në mënyrë elektronike në iif@agro-kos.com. Aplikacionet duhet të dorëzohen tek:

Menaxheri i Granteve dhe Nënkontratave (IIF)
 Programi AGRO i USAID-it
 Lorenc Antoni #36
 Prishtinë
 Kosovë, 10000

Aplikacionet në kopje fizike në adresën e mësipërme ose në verzionin elektronik të Koncept Propozimit do të pranohen nga Z. Agron Selmani, Menaxher i Granteve dhe Nënkontratave (IIF), në iif@agro-kos.com. Afati i fundit është në ora 4 pasdite të datës 31 gusht 2017. Rishikimet do të bëhen të paktën një herë në muaj.

PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

AGRO do të shqyrtojë koncept dokumentet për t'u siguruar se janë përmbushur kërkesat themelore dhe si të tilla të jenë në përputhje me objektivat e Aktivitetit dhe kriteret e pranimi. Koncept dokumentet më pas do të shqyrtohen teknikisht nga ana e nga një komisioni përzgjedhës të IIF-së së Aktivitetit. Ky komision përzgjedhës do të marr pjesë edhe në procesin e përzgjedhjes në fazën e koncept dokumentit si dhe në fazën e aplikimit përfundimtar.

KRITERET E VLERËSIMIT TË KONCEPT DOKUMENTIT

Anëtarët e komisionit do të vlerësojnë meritat e koncept dokumenteve të duke ndjekur udhëzimet e përgjithshme të kriterëve të vlerësimit të detajuara më poshtë. Koncept dokumentet që do të pranohen do të shqyrtohen dhe poentohen në grupe, mujore ose tremujore, varësisht se sa janë pranuar në një periudhë të caktuar, nga një komision teknik i përbërë nga stafi teknik, i menaxhimit të granteve dhe prokurimit të Aktivitetit. Përveç poentimit paraprak të çdo koncept dokumenti, komisioni do të japë një vlerësim të përgjithshëm të koncepteve dhe do të shpreh çfarëdo sugjerimi specifik që mund të ketë në lidhje me aktivitetet e propozuara. Këto sugjerime do të formojnë bazën për të përcaktuar se cilat çështje do të duhet të qartësohen nga organizatat gjatë procesit përfundimtar të aplikimit (në grantet për bizneset fillestare) ose gjatë zhvillimit të planeve afat-shkurt ose afat-mesëm (në grantet për PS-të).

1. **Përshtatshmëria strategjike:** (40 pikë maksimale), duke përfshirë:
 - a) Kontributin ndaj indikatorëve të suksesit të AGRO-s
 - b) Qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit
 - c) Ndikimin e parashikuar për përfituesit
2. **Qasja teknike, ndikimi i pritur dhe përafrimi me objektivat/qasjen e Aktivitetit:** (30 pikë maksimale), duke përfshirë:
 - a) Paraqitjen e problemit në mënyrë të qartë;
 - b) Qëllimet e përshkruara qartë në aspektin e ndikimit dhe kontributit të pritshëm drejt rezultateve të Aktivitetit. Shënim: koncept dokumentet duhet të tregojnë në mënyrë specifike ndikimin e pritur të grantit në:
 - o Krijimin e vendeve të punës
 - o Shitjet e brendshme dhe të eksportit të kulturave/zinxhirëve të vlerave të synuara të Aktivitetit
 - o Industritë ndihmëse/dytësore
 - o Mjedis
 - c) Aktivitetet e përcaktuara qartë dhe demonstrimin e kohezionit gjatë rrjedhës së aktiviteteve;
 - d) Pengesat e mundshme të identifikuara dhe zgjidhjet;
 - e) Përspektivat për qëndrueshmëri afatgjate të përfituesit të ardhshëm
3. **Performanca/Aftësitë organizative në të kaluarën:** (20 pikë maksimale), duke përfshirë:
 - a) Performancën në të kaluarën në projekte të ngjashme (nëse është e aplikueshme);
 - b) Rëndësinë e aftësive të stafit për aktivitetet e propozuara (nëse është e aplikueshme);
 - c) Përvojën brenda rajonit gjeografik;
 - d) Ekzistencën ose angazhimin për të përvetësuar praktikatat e pranueshme të kontabilitetit dhe prokurimit; dhe
 - e) Kapacitetin dhe angazhimin për t'iu përmbajtur udhëzimeve financare të USAID-it.
 - f) Kapacitetin për të kontribuar me pjesën minimale të kërkuar në ndarje të kostos
4. **Marrja parasysh e gjinisë:** (10 pikë maksimale), duke përfshirë:
 - a) Fokusimin në përfitueset e grave pjesëmarrëse;
 - b) Ndikimin tek pjesëmarrëset ose përfitueset.

KRITERET E VLERËSIMIT TË APLIKACIONIT TË PLOTË

Aplikantët që marrin të paktën 70 pikë nga Komisioni për Shqyrtim dhe Vlerësim (KSHV) do të kontaktohen dhe do të iu jepet mundësia të paraqesin aplikacionin e tyre të plotë. Komisioni për Shqyrtim dhe Vlerësim (KSHV) zyrtarisht do të vlerësojë dhe kategorizojë të gjitha propozimet në mënyrë të pavarur dhe uniforme me shkrim, duke përdorur një Formular të Vlerësimit të Aplikimit. Kategorizimet do të bazohen në kritere dhe pika, duke u bazuar në 100 pikët maksimale të lejuara, si vijon:

1. **Qasja teknike, ndikimi i pritur dhe rradhitja me objektivat/qasjen e aktivitetit:** (50 pikë maksimale), duke përfshirë:
 - a) Përkufizimi i problemit në mënyrë të qartë;
 - b) Qëllimet e përshkruara qartë sa i përket ndikimit të pritshëm dhe kontributit drejt rezultateve të aktivitetit. Shënim: koncept dokumentet duhet të tregojnë në mënyrë specifike ndikimin e pritur të grantit në:
 - o Krijimin e vendeve të punës

- Shitjet e brenda vendit dhe eksporti i kulturave/zinxhirëve të vlerave të synuara të Aktivitetit
 - Industrinë ndihmëse/dytësore
 - Mjedisi
- c) Aktivitetet e përcaktuara qartë dhe demonstrimi i koherencës gjatë rrjedhës së aktiviteteve;
- d) Pengesat e mundshme të identifikuar dhe zgjidhjet;
- e) Përspektivat për qëndrueshmëri afatgjate të përfituesit të ardhshëm
2. **Aftësitë organizative:** (20 pikë maksimale), duke përfshirë:
- a) Performancën në të kaluarën në projekte të ngjashme (nëse është e aplikueshme);
 - b) Përvojën brenda rajonit gjeografik;
 - c) Ekzistencën ose angazhimin për të përvetësuar praktikatat e pranueshme të kontabilitetit dhe prokurimit; dhe
 - d) Kapacitetin dhe angazhimin për t'iu përmbajtur udhëzimeve financiare të USAID-it.
 - e) Kapacitetin për të kontribuar pjesën minimale të ndarjes së kostos
3. **Efektiviteti i kostos:** (20 pikë maksimale), duke përfshirë:
- a) Fizibilitetin, realizmin e kostos, arsyeshmërinë, plotësinë dhe efektivitetin e kostos;
 - b) Qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjes/agrobiznesit;
 - c) Ndarjen e kostos (bashkëfinancimit) të siguruar nga përfituesit e mundshëm
 - d) Kontributin nga donatorë të tjerë.
4. **Çështjet e ndërlidhura:** (10 pikë maksimale), duke përfshirë:
- a) Fokusimin në rritjen e mundësive ekonomike për gratë, të rinjtë dhe pakicat.

(100 Pikë maksimale)

Të gjithë aplikantët duhet të marrin një rezultat minimal prej 70 pikësh për t'u marrë parasysh për mbështetje financiare.

Një Komision i Shqyrtimit dhe Vlerësimit (KSHV) i përbërë prej së paku tre personave do të shqyrtojë dhe vlerësojnë të gjitha aplikacionet.

PËRCAKTIMI I PËRGJEGJËSISË

Para se përfituesi i mundshëm i grantit (PS apo agrobiznesi) të inkurajohet për të përgatitur propozimin e plotë, Aktiviteti do të kryejë një vlerësim në terren në mënyrë që të verifikojë se:

- Përfituesi i mundshëm ka kapacitetin për të përmbushur kriteret fiskale të USAID-it, rregulloret dhe procedurat e pranueshme të kontabilitetit të kostos;
- Përfituesi i mundshëm mund të tregojë se fondet e marra do të shpenzohen vetëm për qëllime të projektit, dhe jo për ndonjë projekt ose qëllim tjetër; dhe
- Përfituesi i mundshëm ka sisteme adekuate në dispozicion për të menaxhuar aktivitetin ose projektin.

PROCESI PËRFUNDIMTAR I APLIKIMIT PËR GRANT

Aplikantët që plotësojnë kriteret e PS-ve dhe Fillestarëve/Pakicave/të Rinjve ose Grave dhe dalin nga procesi i shqyrtimit të konceptit me pikët më të larta do të konsiderohen "partnerë strategjikë". Më pas, çdo PS do të punojë me stafin e Aktivitetit që më së afërmi lidhet me përmbajtjen e koncept dokumentit të tyre. Përfituesi i mundshëm i grantit do të përpilojë dhe dorëzojë tek Aktiviteti një grant propozim për negociatë dhe miratim.

Ne rezervojmë të drejtën, në çdo kohë para dhënies së grantit, për të vendosur se granti nuk është merituar.

Tetra Tech është kontraktor i USAID-it për zbatimin e Projektit Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale.